



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 56 shkronja b të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-5017/17, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

### **VENDIM**

### **PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SOCIALE E SHËNDETËSORE**

#### **Neni 1**

74 (shtatëdhjetë e katër) personave në gjendje të rëndë sociale dhe shëndetësore u jepet ndihmë financiare, në shumë të përgjithshme 8700 €.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

#### **Neni 2**

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve n'kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

#### **Neni 3**

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

#### **Neni 4**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Nr.02-553/01-13977/17  
Podujevë,  
27 shkurt 2017



  
Kryetari i Komunës  
Agim Veliu